



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr._____/2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9831,
DATË 12.11.2007, “PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit.”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Paragrafi i parë ndryshon me këtë përmbajtje:

“Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë.

Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, do të vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar.

Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një kësht të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.”.

Paragrafi i katërt ndryshon me këtë përmbajtje:

“Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, për të gjithë përfituesit, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës. Ky mekanizëm do të përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.”.

Paragrafi i pestë shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 13, paragrafi i tretë ndryshon me këtë përmbajtje:

“Ministri përgjegjës për financat urdhëron shpërndarjen e dëmshpërblimit, sipas nenit 12 të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 29, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Gabimet e bëra në të dhëna ose në llogaritjen e masës së shpërblimit, ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Kudo në përmbajtjen e ligjit, emërtimet “Ministria e Financave” dhe “Ministri i Financave” zëvendësohen me fjalët “... ministria përgjegjëse për financat ...” dhe “... ministri përgjegjës për financat ...”.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI